



PROGRAMI I KODIMIT ÇEL APLIKIMET NË E-ALBANIA.

Më datë 23 janar, Qeveria Shqiptare hapi nismën më të re, Programin e Kodimit, duke celur kështu aplikimet për të gjithë të rinjtë, e jo vetëm. Kurset profesionale në fushën e teknologjisë së informacionit për periudhën 3-12 mujore, mbështeten **në vlerën 150,000 deri në 300,000 lekë nga Qeveria Shqiptare** sipas kriterëve që përmbushin aplikantët, të cilët pas përfundimit të kursit mund të integrohen lehtësisht në tregun e punës së teknologjisë.

Gjatë eventit lancues të programit, të rinj që kanë qenë pjesë e këtyre kurseve, ndanë me të gjithë eksperiencat e tyre në fushën e teknologjisë dhe përfitimet në karrierën e tyre pas këtyre kurseve. Gjithashtu, në aktivitet morën pjesë përfaqësues të dhomave të tregtisë, bizneseve, startup-eve, organizatave e fondacioneve, në kuadër të ndërlidhjes që do të ofrojë Programi i Kodimit për të Rinjtë me tregun e punës. Ky program implementohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësisë.

Ofruesit e kurseve profesionale në fushën e teknologjisë së informacionit të kualifikuar deri më tani janë: "Albanian ICT Academy", "BetaPlan Coding Bootcamps", "Holberton School" dhe "SDA by Protik".

Aplikimi online për kurset profesionale kryhet me anë të portalit **e-Albania**, nëpërmjet shërbimit **"Aplikim për Kursin e Formimit Profesional me Mbështetje Financiare"**.

Link-u i aplikimit:

https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=15126



KONFERENCA PËR ARRITJET 2022 DHE OBJEKTIVAT 2023 PËR TË RINJTË DHE FËMIJËT.

Në datën 12 Janar u mbajt konferenca për arritjet dhe objektivat në arsim, sport dhe rini, ku Ministria Bora Muzhaqi, prezantoi disa nga arritjet e Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët për vitin 2022, pa lënë mënjanë objektivat ambiciozë për 2023! Konferenca u përqendrua në disa pika kyçe duke filluar nga kodimi në arsimin parauniversitar i shtrirë në 100 shkolla në të gjithë vendin, programi jashtë orarit mësimor që përfshin 200 shkolla po ashtu në të gjithë vendin, programi i ekipeve sportive si edhe Programi i kodimit për të Rinjtë çeli aplikimet në muajin janar.



DORËZUAM ÇMIMET PËR 12 TË RINJ TË DALLUAR TË VITIT 2022

Më 28 dhjetor 2022, në kuadër të nismës **"I Riu i Muajit"**, organizuam së bashku me **Agjencinë Kombëtare të Rinisë** një mbrëmje e cila promovoi modele suksesi e të rinj të talentuar si pjesë e nismës "I Riu i Muajit". Të ftuarit e nderit ishin **të rinjtë e përzgjedhur si modele frymëzimi përgjatë vitit 2022**, personalitete të ndryshme të artit, sportit dhe kulturës, si edhe miq e familjarë të të rinjve.

Përgjatë mbrëmjes u bë ndarja e çmimeve për secilin prej të rinjve të talentuar të pranishëm. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, pasi dha çmimet përgëzoi të 12-të të rinjtë për arritjet e tyre dhe u uroi suksese të mëtejshme, duke i mbështetur ata në rrugëtimin e tyre.



VIJOJNË TAKIMET KONSULTATIVE ME ORGANIZATAT RINORE/PËR RININË PËR NGRITJEN E BAZË SË TË DHËNAVE PËR RININË.

Procesi i filluar gjatë muajit dhjetor 2022 për ngritjen e Databazës së të Dhënave për Rininë, nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Rinisë, vijoi dhe gjatë janarit me takime konsultative me organizatat rinore/për rininë.


Takimet organizohen në kuadër të VKM-së Nr. 883, "Për Mënyrën e Ngritjes, Administrimit, Mirëmbajtjes së Bazës së të Dhënave për Rininë, si dhe mënyrën e Ndërveprimit të saj me bazat e tjera të të Dhënave Shtetërore" me qëllim krijimin e një logjike funksionimi për ngritjen e bazës së të dhënave për rininë, si dhe shkëmbimin e sugjerimeve me aktorët e shoqërisë civile për mënyrën e ndërlidhjes së saj me databazat e tjera shtetërore.

Të dhënat e mbledhura nga ky takim do të përdoren nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë për ngritjen e bazës së të dhënave për të rinjtë. Gjatë takimit u vendos krijimi i një grupi pune me përfaqësues të organizatave rinore/për rininë që do të ndjek të gjithë procesin e ngritjes së bazës së të dhënave për rininë.

THIRRJA VII, E PROGRAMIT KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS.

Faza e parë e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës përfundoi me sukses në 12 dhjetor 2022, dhe gjatë janarit të këtij viti (2023) të rinjtë u pajisen me certifikatë të lëshuar nga Ministri Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Departamenti i Administratës Publike.

Këtë muaj ishte faza e fundit dhe më e rëndësishme e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, punësimi i praktikantëve nga institucionet përkatëse ku ata kanë kryer praktikën me kontratë 1-vjeçare. Nga 457 të rinj që kanë zhvilluar praktikën e punës pranë institucioneve, OJF-ve dhe shoqërive tregtare, **155 prej tyre janë tashmë të punësuar me kontratë 1-vjeçare** për të zhvilluar më tej karrierën e tyre.



Link-u i aplikimit: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=15126